



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT BUJQËSOR SHKODËR

PLANI I INTEGRITETIT

**AGJENCIA RAJONALE E
EKSTENSIONIT BUJQËSOR SHKODËR**

2025-2027

Adresa: Bulevardi "Zog i I-rë" Shkodër



Grupi i Punës i ngritur për hartimin e Planit të Integritetit në AREB Shkodër ,në zbatim të
Urdhërit Nr. 37 date 23.05.2025 Mbi ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të
Integritetit për AREB Shkodër

Z. Sherif Brahaj Kryetar\ Koordinator i Grupit Përgjegjes i Komanduar i Sektorit të Specialisteve
të Profilizuar AREB Shkodër.

Z.Marije Lumçi Anetare Përgjegjese për Sektorin Finances dhe Shërbimeve

Z.Rifat Kodra Anetar Përgjegjes i Sektorit SEB Shkodër

Znj. Dila Kola Anetare Përgjegjese e Sektorit SEB Lezhë

Z.Qemal Memishaj Anetar Përgjegjes i Sektorit SEB Kukës

Z.Sherif Brahaj Antar Përgjegjes i sektorit të Specialisteve të Profilizuar

Ky Plan Integriteti hartohet në përputhje me dokumentet strategjik të miratuar nga Ministria e
Drejtësisë, në cilësime të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit e cila ka përgjegjësi
kryesore të hartojë politika në luftën kundër korrupsionit dhe të bëjë monitorimin e zbatimit të tyre
në institucione , si dhe në kuadër të kordinimit të procesit të vlersimit të riskut në institucioneve të
vartësisë në MBZHR ,ardhur nga MBZHR dhe administruar pranë AREB Shkodër me shkresën
Nr.2659/3 me datë 16.05.2023.


Po kështu ,ky plan i referohet metodologjisë së Vlersimit të Riskut të Integritetit të përgatitur nga
Ministria e Drejtësisë ,e cila në vetvete është relevante në këtë aspekt për të gjitha institucionet
e qeverisjes qendrore si dhe atyre në vartësi.

Synimi i këtij padyshim është që të kontribuojë në forcimin e procesit të planifikimit dhe
menaxhimit të riskut të integritetit në AREB Shkodër .



TABELA E PËRMBAJTJES

1.DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL	4
2.LISTA E SHKURTESAVE	6
3.HYRJE	7
4.PROCESI I HARTIMIT TE PLANIT TE INTEGRITETIT	8
5.QASJA METODOLOGJIKE	10
6.OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2025-2027	11
7.RISQET EDHE FAKTORET E RISQEVE TE INTEGRITETIT	14
8.MONITORIMI I PLANIT TE INTEGRITETIT	18
9.PLANI I VEPRIMIT	21



DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Përballja efektive me korrupsionin për Agjencinë e Ekstensionit Bujqësor Shkodër AREB është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëadministrimin, si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira karshi fermerëve .AREB Shkodër ka përgjegjësitë kryesore të menaxhimit financiar; menaxhimit të burimeve njerëzore; monitorimin , kontrollin, dhe mekanizmat kundër korrupsionit; transparencën; arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve dhe informacionit, menaxhimit të sektorit të ekstensionit , si edhe menaxhimit të Sektorit të Specialisteve të Profilizuar , në kuadër të organizimit dhe funksionimit të AREB Shkodër. Duke patur një rol qendror në këtë fushë, jemi të vetëdijshëm se duhet të jemi ndër të parët që të japim shembullin tonë, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj. Ky plan integriteti është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorruption. Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të AREB Shkodër dhe masat konkrete për adresimin e tyre.

Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, udhëzimeve dhe praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.

Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër, AREB ka këto prioritetet primare që vizionojnë veprimtarinë e saj:

- Gjenerimi i perfitimeve të prekshme dhe të përhershme për komunitetin e fermerëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ekstensionit.




- Mbledhjen, perpunimin, zhvillim dhe shperndarjen e statistikave tek perdoruesit ne funksion te politik perberjes per zhvillimin bujqesor dhe blegtoral.
- Forcimi i kapaciteteve organizative dhe funksionale te AREB.
- Përmirësimi i shërbimit te ekstensionit përmes trajnimeve të fokusuara dhe të vazhdueshme.
- Forcimi i sigurise dhe të shëndetit , ne pune.
- Përmirësimi i proceseve të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e institucionit.
- Përmirësimi i kushteve infrastrukturore të institucionit , nëpërmjet investimeve dhe pajisjeve logjistike ne vazhdimesi.



Lista e Shkurtesave

MBZHR	Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural
AREB	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqesor
SEB	Sektori i Ekstensionit Bujqesor
MVRI	Metodologjia e Vlersimit te Riskut
PSV	Procedure Standarte Veprimi
PT	Program Transparences
VKM	Vendim i Keshillit te Ministrave
MVRI	Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit



HYRJE

Miratimi i Planit të Integritetit për Agjencinë e Ekstensionit Bujqësor Shkodër, përfaqëson vullnetin institucional për fuqizimin e mëtejshëm të integritetit institucional, transparencës dhe parandalimit të korrupsionit në AREB Shkodër. Ky dokument u hartua gjatë periudhës Maj 2025. Është hartuar duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr. 334, datë 07.10.2021 si dhe duke u fokusuar te Plani i Integritetit i miratuar nga MBZHR.

Misioni i AREB Shkodër është përmisimi i shërbimit të ekstensionit përmes përfshirjes më të gjerë të fermerëve në proceset e këshillimit, konsultimit, advokimit dhe monitorimit me synimin për të gjeneroj përfitime të prekëshme dhe të përhershme për komunitetin e fermerëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ekstensionit.

Përbushja e këtij misioni nëpërmjet garantimit të zbatimit të ligjit, transparencës dhe respektit për dinjitetin njerëzor.


Plani i Integritetit për Agjencinë e Ekstensionit Bujqësor Shkodër mbështetet dhe është në përputhje me politikat e Qeverisë Shqiptare të orientuara drejt perspektivës për aderim në Bashkimin Evropian, të prezantuara nëpërmjet dokumenteve kyçe, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet (SKZHI), Strategjia Ndër-sektoriale e Drejtësisë (SND), Strategjia e Luftës kundër Korrupsionit, si dhe Plani i Veprimit për adresimin e 12 prioritetëve kyçe të Komisionit Evropian në vecanti atyre që i përkasin MBZHR.

Kuadri i përgjithshëm ligjor mbi bazën e të cilit funksionon Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor përfshin:

- VKM Nr.147, Datë .13.03.2018 “Për krijimin ,organizimin dhe funksionimin e Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor”,
- Ligji nr.9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rual”
- Ligjit nr. 38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”
- Ligjit Nr. 17/2018 “ Për Statistikat Zyrtare”.
- Udhëzimit Nr.19 dt 3.11.2014 i ndryshuar DPT
- Rregullore e Përgjithshme e AREB Shkodër, miratuar me urdhër Ministrit të MBZHR
- Manual i Metodologjise Keshilluse per Specialistet e Ekstensionit Bujqësor
- Kodi i Etikës i MBZHR,

Akte të tjera ligjore mbi bazën e të cilave funksionon AREB Shkodër janë edhe:

- Kodi i Punës
- Ligji për statusin e Nënpunësit Civil nr.152/2013, i ndryshuar




- Kodi i Procedurave Administrative 2015.
 - Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",
 - Ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
 - Ligji Nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
 - Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
 - Ligji nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
 - 7 • Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"
 - Ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".
 - Ligji Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" si dhe i gjithë kuadri tjetër ligjor që rregullon marrëdhëniet e menaxhimit financiar me sistemin e institucionit qendror në Republikën e Shqipërisë.
 - Ligji Nr.9154 dt.06.11.2003 "Per arkivat".
- Ligji Nr.8457 dt.11.02.199 "Per informacionin e klasifikuar "Sekret Shteteror" (i ndryshuar)
- Ligjit nr. 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor"
- Ligji Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" si dhe i gjithë kuadri tjetër ligjor që rregullon marrëdhëniet e menaxhimit financiar me sistemin e institucionit qendror në Republikën e Shqipërisë.

PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

1. Ngritja e Grupit të punës me Urdhërin Nr. 37 date 23.05.2025 Mbi ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit për AREB Shkodër .Grupi punes perbehej nga drejtuesit e sektoreve, grupi drejtohej nga Koordinatori AREB Shkodër ,i cili siguroi mbarvajtjen e procesit dhe koordinimin e aktiviteteve ne institucion.
2. Përgatitja e programit të punës për secilin anëtar të sektorit .



Referuar urdherit të titullarit AREB ,koordinatori percaktoj detyrat per antaret e grupi te punes per hartimin e Planit te Integritetit.

3. Informimi i detajuar i punonjësve të institucionit mbi metodologjinë dhe aktivitetet e trajnimit e planifikuara për përgatitjen e planit të integritetit .

Pegjegjesat e gjithë strukturave të organigrames së AREB, njohen punonjesit me rendesine e hartimit të këtij dokumenti strategjik.

4. Vlerësimi fillestar i integritetit në të gjithë sektorët përkatës të institucionit (fokus – grupe)

Ne funksion të vlersimit fillestar të integritetit u shpërndan dhe plotësua një ankete nga stafi i AREB.

5. Mbledhja e informacionit të nevojshme nga çdo sektor .

Nga studimi dhe përpunimi i anketes së plotësuar ,u mbledhën informacioni i nevojshëm për hartimin e raportit ,lidhur me integritetin fillestar.

6. Shqyrtimi dhe analizimi i informacionit dhe i dokumentacionit të mbledhur lidhur me vlerësimin, ekspozimin dhe rezistencën e institucionit ndaj risqeve

7. Identifikimi dhe analizimi i faktorëve të riskut .

Gjatë kësaj faze, grupi i punës i kushtoi rëndësi analizës së kuadrit ligjor dhe atij të brendshëm rregullator për veprimtarinë e institucionit. Në këtë fazë u përfshi dhe analiza e raporteve të AREB Shkodër që lidhen me veprimtarinë e institucionit. Me tej grupi i punës operoi me identifikimin përshkrimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të AREB si dhe me veprimet për të adresuar boshllëqet.

8. Vlerësimi i risqeve të identifikuar

Grupi i Punës identifikoi dhe analizoi faktorët e riskut që mund të priten të favorizojnë ose risin risqe të tilla. Me tej risqet e vlersuara dhe faktorët e tyre u renditën sipas përparsisë. Procesi vijoi me vlersimin e efektivitetit të masave ekzistuese të kontrollit në AREB për risqet e vlersuara si dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre në vazhdim.


9. Hartimi i masave për trajtimin e risqeve të identifikuar me qëllim përmirësimin e integritetit .

10. Prioritizimi i masave zbatuese dhe rregullatore për minimizimin e risqeve .

11. Përgatitja e regjistrit të riskut dhe planit të veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit

12. Përgatitja e raportit për gjendjen e integritetit në institucion .

13. Shqyrtimi i planit të propozuar të integritetit.



QASJA METODOLOGJIKE

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor në përputhje me MVRI, u përdor:

Metoda cilësore, e cila u nda në disa etapa:

- Takime periodike me punonjësit e AREB– fokus grupe, për të diskutuar risqet e secilit sektor / fushës së mbikëqyrjes,
- Takime me përfaqësues teknikë dhe ekspertët të jashtëm.
- Analizë e kuadrit rregullator të brendshëm,
- Analizë e veprimtarisë së AREB dhe sektorëve përkatës .

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 2025-2027

Si rezultat i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, nëpërmjet këtij Planit Integriteti, AREB Shkodër ka vendosur pesë objektiva të realizueshëm brenda periudhës 2025-2027, nëpërmjet të cilëve synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e konstatuara.

Objektivi përfundimtar i këtij plani është ndërtimi i një sistemi të brendshëm efektiv dhe forcimi i kulturës së integritetit institucional.

Objektivat strategjikë të Planit të Integritetit 2025-2027 janë:

1. Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit .
2. Përmirësimi i proceseve të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies me fermeret dhe publikun.
3. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe fuqizimi i tyre përmes trajnimeve të fokusuara dhe të vazhdueshme.
4. Forcimi i integritetit në sistemin finances dhe prokurimeve .
5. Administrimi financiar për përdorimin me efikasitet, kursim e dobishmëri të burimeve financiare dhe rezervave ekonomike për të realizuar politikat e programit të burgjeve të shprehura në buxhetin e përcaktuar.

Këto objektiva strategjikë bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e **Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit**, si edhe me paketën e legjislatimit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik.



Këto objektiva do të udhëheqin punën e AREB përgjatë periudhës në vijim, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat.

RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT

Në këtë seksion paraqitet në mënyrë të përmbledhur analiza dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në AREB Shkodër

VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E FINANCËS / BUXHETIT:

Në zbatim të VKM-së nr. 516, datë 1.7.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Pëi miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020" dhe miratimin e Planit të Veprimit 2025-2027 dhe në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e vartësisë, të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, me urdhrin Nr. 41, datë 24.05.2023, është hartuar raporti i vlerësimit të riskut të integritetit për Sektorin e Financës / Buxhetit.

Spektori i Financës ka për mision të mbështesë punën e sektorëve funksionalë të AREB-it, nëpërmjet koordinimit dhe harmonizimit të punës së financës duke përdorur me efikasitet dhe efektivitet burimet financiare për të përmbushur misionin parësor të gjithë AREB-it Shkodër dhe objektivat e përgjithshme të tij.

Realizimi i këtij misioni synon të japë siguri objektive për vijimësinë e një aktiviteti normal të sistemit, duke përmbushur njëkohësisht nevojat për investime në pajisje, infrastrukturë zyre dhe shpenzime të tjera operative në të gjithë sistemin e burimeve. Ky harmonizim plotësohet me monitorimin e vazhdueshëm të përdorimit të fondeve buxhetore nga staf punonjësish të rekrutuar me kujdes dhe një dokumentim e ruajtje të sigurtë të korrespondencave, që realizohen brenda këtij sektori. Realizimi i tre objektivave themelore AREB-it mbështetet edhe nga kontributet e punës së financës, nëpërmjet arritjes së objektivave specifike të mëposhtëm:

I. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

Administrimi financiar për përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të burimeve financiare dhe rezervave ekonomike për të realizuar politikat e programit të MBZHR -së të shprehura në buxhetin vjetor të miratuar. Përshkrimi i nën/proçeseve:

- Hartimi i programit Buxhetor Afat mesëm (PBA)
- Hartimi i Bilancit vjetor për AREB-it Shkodër .
- Procedurat e kryerjes së pagesave, rregjistrimit dhe kontabilizimit të tyre.
- Procedurat e administrimit/dokumentimit të vlerave monetare të institucionit.
- Procedurat e administrimit/ dokumentimit të vlerave materiale të institucionit.



- Mbajtja dhe administrimi i të dhënave mbi llogaritë kontabël gjatë vitit ushtrimor.
- Kryerja e pagesave të pagave, dietave, sigurimeve dhe tatimeve çdo muaj .
- Raportimet mujore mbi ecurinë e fondeve buxhetore për AREB Shkodër
- Detyra të tjera të lindura gjatë aktivitetit normal të sektorit.

Strukturat e përfshira: Sektori Financë / Buxhet Mbështetës: Nëpunës Zbatues si dhe të gjithë sektorët e tjerë në AREB Shkodër.

Vlerësimi i faktorëve të riskut sipas specifikës

Financat publike efektive janë një mjet i rëndësishëm për vendosjen e prioriteteve institucionale ekonomike dhe sociale brenda burimeve në dispozicion të institucionit

Në të kundërt, menaxhimi joefikas ose joadekuat i financave publike mund të rezultojë në humbje financiare, ulje të investimeve totale dhe ulje e infrastrukturës, performancë e dobët e institucioneve. Faktorët e riskut të identifikuar sa lidhet me buxhetin dhe menaxhimin financiar janë si më poshtë

- Planifikimi jo i mirë: Përpjekja e dështuar për të ndërlidhur politikën, planifikimin dhe buxhetimin mund të kontribuojë në rezultate të dobëta buxhetore.
- Paaftësia për të parashikuar në mënyrë realiste mund të çojë në mungesë transparence gjatë ekzekutimit të buxhetit.
- Financimi i pamjaftueshëm i nevojave për mallra dhe mirëmbajta mund të rezultojnë në performancë të ulët të AREB-it.
- Mungesa e lidhjes ndërmjet buxhetit të parashikuar dhe atij të ekzekutuar.

Risqet e Integritetit

- Menaxhimi i i raportimeve financiare jo në kohë dhe joefikase mund të rezultojnë në mundësi për rreziqe të veprimeve financiare (krijimi detyrimeve, krijimi i moslikuiditetit për shërbime të ndryshme)
- Përgatitja e Projekt – buxhetit afatmesen dhe afatgjate jo efikas krijon vështirësi të shumta për mosrealizimin e funksionit dhe qellimeve të njësive shpenzuese në aktivitetin e tyre.
- Ndarja e buxhetit jo në përputhje të plotë të kërkesave reale çon në mos realizimin e nevojave jetike të njësive shpenzuese që ka AREB Shkodër.
- Zyrtarët mund bëjnë modifikime të paautorizuara në bazën e të dhënave të listës së pagave për përfitime personale. Zyrtarët mund deklarojnë detaje të pasakta të dhënash në përpunimin e listës së pagave. Si rezultat, pagat mund t'iu paguhen punonjësve fiktivisht.



- Zyrtarët mund të japin informacion të rremë për rimbursimin e shpenzimeve, të bëjnë kërkesa për rimbursim bazuar në fatura të pavërteta. Verifikimi jo i duhur i faturave çon në tepriçë pagesash.

Strategjitë potenciale për menaxhimin e riskut:

- Të sigurohet informacion në mënyrë sistematike para titullarit të AREB-it. Parashtron për njohje dhe vlerësim të gjitha dokumentet kontabël dhe financiar të nevojshëm për një miratim korrekt mbi buxhetin.
- Në vijim të rregulloreve të institucionit, të prezantohet dhe të zbatohet një rregullator operacional i qartë dhe gjithëpërfshirës nën kornizën e menaxhimit buxhetor dhe atij fiskal. Mekanizmat për buxhetimin dhe formulimin e politikave duhet të jenë në mënyrë eksplicite, projektuar për të përforcuar koordinimin dhe kohezionin në vendimmarrje të saktë dhe efikente
- Të planifikohet buxheti duke u bazuar në informacione të besueshme.
- Të planifikohet prokurimi i rakorduar me zërat buxhetorë të parashikuar.
- Të trajnohet i gjithë personeli përkatës në kuadër të fuqizimit të tyre si asete.
- Ndërtimi i kapaciteteve për pjesëmarrje efektive të të gjithë stafit përkatës në procesin buxhetor në të gjitha fazat e tij.
- Vëmendje e shtuar në drejtim të sigurimit të kapaciteteve adekuate të drejtuesve të njësive të cilat duhet të hartojnë buxhetet e tyre të parashikuara.
- Përmes të gjitha fazave të procesit buxhetor (formulimi, miratimi, zbatimi dhe vlerësimi), institucionit t'i ofrohet në kohë informacion i plotë, transparent dhe gjithëpërfshirës mbi aktivitetin fiskal të kaluar, aktual dhe të parashikuar, duke specifikuar objektivat e politikës fiskale, kuadrin makroekonomik, bazën e politikave për buxhetin dhe rreziqet kryesore fiskale të identifikueshme.
- Të sigurohet që të dhënat e buxhetit të jenë të klasifikuara dhe të paraqitura në një mënyrë miqësore dhe të thjeshtë gjë e cila të mundësojë analizën e politikave dhe promovimin e llogaridhënies.
- Të sigurohet pjesëmarrja (përfshirja) e punonjësve në formulimin e programit të shpenzimeve.
- Të raportohet në kohë. Raportimi të jetë gjithëpërfshirës, i besueshëm, dhe të identifikojë devijimet nga buxheti. Dokumentat e financave publike duhet të mbulojnë buxhetet, raportet brenda vitit, raportet e mesit të vitit, raportet e fundvitit dhe raportet e auditimit.
- Të sigurohet disponueshmëria dhe zbatimi i procedurave të specifikuara qartë dhe gjithëpërfshirëse për ekzekutimin dhe monitorimin e shpenzimeve të miratuara.
- Të vërtetohen faturat me dokumentacion mbështetës si p.sh kërkesa dhe urdhra blerjeje për të ndihmuar të sigurohet që të gjitha pagesat janë për mallra dhe shërbime të ligjshme.



- Të sigurohet rakordimi i rregullt dhe i saktë i të gjitha transaksioneve.

VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR PROKURIMET

Prokurimet si detyrë funksionale ka si qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit për plotësimin e kërkesave dhe nevojave duke u bazuar Rregullores së Brendshme, si dhe përdor të gjithë legjislacionin material dhe procedural në fuqi, në mënyrë që aktet e nxjerra si produkt i veprimtarisë dhe punës së këtij sektori në permbushjen e këtij qëllimi të jenë sa më të vlefshme.

I. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë ,lidhur me Prokurimet Publike mbrojnë interesat e AREE SI.kodër duke mbajtur në konsideratë:

- a) Rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik;
 - b) Mirëpërdorimin e fondeve publike dhe uljen e shpenzimeve procedurale;
 - c) Nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - d) Nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - e) Ofrimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
 - f) Të operuarit me integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
- Siguron realizimin në kohë të procedurave për prokurimin e fondeve sipas buxhetit të miratuar.
 - Përgatit përgjigjet për kërkesat e operatorëve ekonomikë, duke u konsultuar paraprakisht me strukturat e tjera në institucion që janë përgjegjëse për rastet konkrete, dhe i diskuton ato me strukturat eprore.
 - Përgatit ne vartesi te udhezimeve materialet shkresore të nevojshme dhe të gjitha aktet e tjera procedurale drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik, Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara, Ministrisë së MBZHR etj..

II. Vlerësimi i risqeve Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, për Prokurimet Publike, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e AREB-it mund t'i konsiderojmë:

Reputacional

- a) Konflikti i interesit i nëpunësve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, parashikuar në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005.



b) Trajtim jo i barabartë dhe diskriminues ndaj operatorëve ekonomikë, me operacione jo transparente e në mënyrë jo proporcionale, ku një kontribut tejet të rëndësishëm në këtë detyrë luan sektori i prokurimeve.

c) Kriteret e vendosur nga pjesëtarët e grupeve të punës të përgatitjes së specifikimeve teknike, kriterëve kualifikues dhe prokurimi në tërësi mund të përgatiten me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

Operacional /procedural

a) Personel i pamjaftueshëm për të mbuluar proceset e procedurave të prokurimit publik

b) Konfuzion rolesh për shkak të vakancave

c) Ngarkesë e lartë që ka risk të përkthehet në vonesa.

d) Mungesa e një juristi në organigramen e AREB

Procedurale. Financiar

a) Zbatimi jo me efikasitet i ligjit të prokurimit publik, dhe mungesa e nxitjes dhe inkurajimi i operatorëve ekonomikë shkakton një keqpërdorim të fondeve publike duke krijuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

4. VLERËSIMIT I RISKUT TË INTEGRITETIT NË KUADËR TË SË DREJTËS PËR INFORMIM

5. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E BURIMEVE NJERËZORE

Sektori Burimeve Njerëzore për shkak të natyrës së punës së tij, duke qenë se detyrat funksionale lidhen me procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore, rekrutimin dhe përzgjedhjen e stafit nëpërmjet një procesi transparent, identifikimin e nevojave për rritjen profesionale të stafit, si dhe zbatimin e kodit të sjelljes dhe etikës në institucion, me qëllim krijimin e vlerave të qëndrueshme, drejtimin strategjik të politikave dhe planeve, si dhe efikasitetin në kryerjen e detyrave, që të mund të realizohet misioni i AREB-it.

Sektori i Burimeve Njerëzore organizon dhe rregullon veprimtarinë e saj duke u mbështetur në akte ligjore e rregullave të cituara si më lartë .



II. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

Konsolidimi i Sistemit të menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

- Drejton procesin e procedurave të punësimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në sektorët e varësisë, suke siguruar një proces objektiv, transparent dhe të hapur, sipas udhëzimeve dhe praktikës së përcaktuar nga DAP dhe Kodi i Punës në RSH.
- Mbështet fuqishëm procesin e ngritjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm, nxit përkushtimin e stafit në kryerjen e detyrave funksionale.
- Mban dokumentacionin për kontrollin, garanton plotësimin e dosjes teknike të stafit, rifreskimin dhe pasurimin e tyre për punonjësit e AREB-it, si dhe paraqet pranë sektorit të financës kohën e vjetërsisë në punë të punonjësve për pagesën e tyre konform rregullave çdo fund viti dhe referuar ndryshimeve ligjore në vijim.
- Zhvillon një sistem për raportimin e brendshëm, mban një sistem efektiv komunikimi dhe informimi.
- Ndjek plotësimin e librezave të punës dhe pasqyrimi i të gjitha ndryshimeve të pozicionit të punës së stafit.
- Siguron, përgatitjen dhe administrimin e vlerësimeve vjetore të stafit, si dhe asiston dhe bashkëpunon me drejtorët e drejtorive për realizimin e vlerësimeve individuale, konfirmimin e nëpunësve dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit.
- Ndjek procesin e procedurave disiplinore për stafit, si dhe përgatit udhërat e emërimit, lirimit, kontratave të punës, si dhe kryerjen e lejeve vjetore të stafit.
- Harton dhe ndjek praktikën e standardizuar të menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjithë AREB-in, si dhe sipas rastit, monitoron zbatueshmërinë e urdhrave të titullarëve.
- Kryen kontrollin e njësive të burimeve njerëzore në sektorë të AREB-it, si dhe këshillon titullarin.
- Ndjek dhe koordinon punën për përfundimin e praktikave dokumentare, si dhe udhëheq procesin e ristrukturimit dhe reformimit të strukturave të burimeve njerëzore për përmirësimin e zbatimit të politikave të burimeve njerëzore.
- Vlerëson, aftësitë dhe performancën e përgjithshme të specialistëve të sektorit, duke përgatitur vlerësimet me shkrim të rezultateve në punë, duke diskutuar ecurinë dhe duke theksuar fushat në të cilat janë të nevojshme të bëhen përmirësime, si dhe ndihmon titullarin për administrimin e këtij procesi nga sektorët e tjerë të AREB-it.
- Siguron ndjekjen e respektimit të orarit të punës, disiplinës dhe etikës në AREB Shkodër.
- Mban kontakte me fermerë e qytetarë të interesuar për tërheqjen e dokumentacioneve, si dhe ofron asistencën e nevojshme.
- Mban kontakte me përfaqësues të institucioneve të ndryshme, lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe dokumentacione të ndryshme.

III. Vlerësimi i risqeve

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit burimeve njerëzore, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

Operacional /proceduralë



a. Personel i pamjaftueshëm për të mbuluar proceset e rëndësishme në stafin e AREB-it por dhe atë rreth 7 vakanca në sistem të cilat natyrisht duhet proceduar sipas parashikimeve ligjore në plotësimin e tyre duke ndikuar kështu edhe në rritjen e performancës së punonjësve dhe evitimin e çdo elementi abuziv.

Financiar

b. Shpenzime të larta si pasojë e pagesës së dietave për shkak transferimi apo komandimi në institucione të parashikuara në aktet ligjore, përkatëse .

6.VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E ARKIV - PROTOKOLLIT

Spektori i Arkiv-Protokollit ka për mision të mbështesë punën e sektorëve funksionalë nëpërmjet koordinimit dhe harmonizimit të punës së Sektorit të Protokollit me të gjithë sektorët e tjerë të AREB-it, duke punuar me standard të lartë integriteti profesional, transparent dhe etik në zbatim të ligjit dhe rregullave për të përmbushur misionin parësor të të gjithë AREB-it dhe objektivave të përgjithshëm të tij. Realizimi i këtij misioni synon të japë siguri objektive për vijueshmërinë e një aktiviteti normal të institucionit, duke përmbushur njëkohësisht edhe të gjitha objektivat e sektorit. Ky harmonizim plotësohet me administrim eficient të dokumentacionit sipas ligjit dhe rregullores, si dhe shpërndarje të menjëhershme të tij.

I. Realizimi objektivave themelore

Realizimi i objektivave themelore të AREB-it mbështetet edhe nga kontributet e punës së Sektorit të Protokoll-Arkivit, nëpërmjet arritjes së objektivave specifike të mëposhtme:

- 1.Administrimi i sigurtë i postës sekrete dhe informacionit të klasifikuar.
- 2.Zbatimi i parimeve, rregullave dhe procedurave për ruajtjen e sigurisë, integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit të protokolluar dhe arshivuar.
- 3.Shpërndarja e menjëhershme dhe brenda të gjitha afateve e të gjithë dokumentacionit të postës së thjeshtë dhe sekrete, si brenda AREB-it ashtu edhe në të gjitha institucionet e tjera.

Administrimi i sigurtë i dokumentacionit shkresor të ardhur në AREB-it, si dhe arkivimi i tij.

II. Rrjedha e punës në Sektorin e Arkivës

- Puna e Sektorit të Arkivës kryhet në bazë të Ligjit për Arkivat Nr. 9154, datë 06.11.2003.
- Marrja e dokumentave bëhet në bazë të një procesverbali i cili është i firmosur nga të dy personat, marrësi në dorëzim dhe dorëzuesi. Procesverbali përmban numrin e dokumentit, përshkrimin dhe numrin e fletëve të dorëzuara.
- Bëhet përpunimi tekniko-shkencor i dosjeve.
- Organizimi i punës për shfrytëzimin e dokumentave për plotësimin e kërkesave operative duke hartuar për këtë qëllim mjete të ndryshme informative.
- Dalja e shkresave nga arkivi i institucionit (fotokopje e origjinalit, e njehsuar me vulën e vogël të institucionit) bëhet në bazë të rregullave në fuqi.



- Dalja e shkresave për të gjitha Sektoret e Institucionit bëhet në bazë të një memo-je sqaruese, ose e-mail zyrtar, ku kërkohet arsyeja dhe përdorimi i informacionit.
- Dalja e shkresave nga institucioni për kërkesa të ndryshme që vijnë nga Gjykata, Prokuroritë, Interpoli dhe institucione të tjera.
- Përpilimi, shtypja, shumëfishimi i dokumenteve, brenda mjediseve zyrtare të institucionit.
- Marrja e dosjeve të tenderave nga Sektori i Prokurimeve, në baze të procesverbalit ku listohen të gjitha shkresat që ndodhen në praktikën e tenderimit. Procesverbalë është i firmosur nga të dy personat, marrësi në dorëzim dhe dorëzuesi.
- Vëndosja e dosjeve që vijnë nga Sektori i Protokollit për në Arkivë, ndarja në rafte sipas vitit dhe sektorëve.
- Vëndosja e dosjeve nëpër dollape dhe rafte, duke etiketuar vitin e dosjeve të sektorëve të ndryshëm, dhe duke përpiluar për secilin raft apo dollap një inventar për përmbajtjen e të gjitha dosjeve.
- Marrja në dorëzim edhe e ditareve të protokollit, të sekretuara në bazë të numrit të fletëve dhe numrit të dokumenteve.
- Dokumentat e marra në arkivë, regjistrohen në Librin e Arkivës me numrin e dosjes, emërtimin dhe në përputhje me procesverbalin e dosjes.
- Marrja në dorëzim e librave të protokollit pasi sekretohen me vulë në fund të librit dhe me numrin e dokumentave të protokolluara.
- Bashkërendimi i punës me Sektorin e Protokollit duke marrë pjesë në mbylljen e dosjeve të hapura sipas pasqyrës emërtuese.
- Të gjitha dokumentat e dixhitalizuara, (nëse prodhohen) arkivohen çdo vit në CD, dhe ruhen në kasafortën e Arkivës së AREB-it.
- Përgjigjja e disa shkresave në rrugë elektronike nëpërmjet email-it zyrtar, për përdorim të brendshëm.

III. Faktorët e riskut

Identifikimi i faktorëve të riskut që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit të Arkiv - Protokollit, si dhe impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund të konsiderojmë,

Operacionalë

Shkatërrim dokumentacioni si rezultat

- i faktorëve të jashtëm .
- mungesës së infrastrukturës së duhur në zbatim të plotë të standarteve në fuqi që normojnë veprimtarinë e këtij sektori.
- Mungesë informacioni në zbatim të akteve ligjore .



7. MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Objektivat strategjikë të këtij plani integriteti, do të implementohen nëpërmjet planit të veprimit, i cili parashikon afatet specifike, strukturat përgjegjëse dhe të dhëna të tjera për secilin aktivitet të parashikuar.

Monitorimi është periodik (çdo 6 muaj) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara në planin e veprimit. Koordinatori është përgjegjës për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efikente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioriteteve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimave për planifikim më të mirë në të ardhme.

8. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E SEB

Misioni

Te krijoj një mjedis social të pershtatshëm për fermerët në funksion të shërbimit të ekstensionit të barabartë për të gjithë duke krijuar një status të konsoliduar për të ardhmen e tyre në treg si pjesë e rëndësishme e ekonomisë.

I. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

1. Menaxhimi i shërbimeve dhe mbjelljeve të reja në frutikulturë *ullishte, vreshta, pemë frutore nëpërmjet keshillimit nga ekstensionistët.
2. Keshillim intensiv i fermerëve që kultivojnë perime në sera.
3. Mbledhja, përpunimi, zhvillimi i statistikave në funksion të relizimit të Rregjistrit të Fermerëve, Vjetarit Statistikor, dhe raportimit të evidencave koherente.
4. Keshillim i fermerëve me teknologji bashkohore për kultivimin e grurit.
5. Shtimi i sipërfaqeve me bimë mjekësore.
6. Rritja e krereve në blegtori.
7. Përpunimi i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

II. Vlerësimi i risqeve

Identifikimi i faktorëve të risqeve që lidhen me aspektin e integritetit, të sektorit burimeve njerëzore, si dhe i impaktit që ata mund të kenë në integritetin e institucionit mund t'i konsiderojmë:

Operacional /proceduralë



- a. Personel i pamjaftueshëm për të mbuluar proceset e rëndësishme në stafin e AREB-it nga 7 vakanca në sistem të cilat ndikojnë në rritjen e performancës së punës.
- b. Konfuzion rolesh për shkak të vakancave .
- c. Ngarkesë e lartë në ushtrimin e detyrës që ka risk të përkthehet në vonesa.

Operacional + Përputhshmërie

- a. Mos njohja e teknikave të keshillimit dhe informimit.
- b. Mos njohja e modeleve dhe parimeve të komunikimit.
- c. Mos njohja e niveleve të kompetencave dhe mungesa e etikës.
- d. Keqinformimi dhe krijim demagogjik financiar.

III. Vlerësimi i faktorëve të riskut

Operacional + Përputhshmërie

- Mungesë informacioni në zbatim të akteve ligjore .
- Mungesë informacioni mbi keshillimin e duhur nga ekstensionistët.

Reputacional

Dëmtim i imazhit të AREB

9. VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT PËR SEKTORIN E SPECIALISTEVË TË PROFILIZUAR

Misioni

Sensibilizimi i Sherbimit të Ekstensionit AREB , për të rritur ndergjegjësimin e komunikimit të Ekstensionistëve dhe specialistëve të profilizuar për të mundësuar të fermerët mendime të shëndosha në marrjen e vendimeve të drejta , në funksion të zhvillimit të aktivitetit të tyre bujqësor e blektoral maksimizimin e fitimit të tyre.

1. Objektivat, detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

1. Implementimi i Strategjisë së MBZHR në kuadrin e rekomandimeve të BE për Sherbimin e Ekstensionit në AREB në funksion të zhvillimit Bujqësor e Blektoral. Mënyra e masave paraprake për të parprirë procesin "Për Censin e Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore".
2. Monitorimi dhe Kontrolli i Performancës së Sherbimit të Ekstensionit në SEB-et Shkodër, Lezhë dhe Kukës.
3. Intensifikimi i trajnimeve, ditë fushe e demonstrime nga Sektori i Profilizuar në bashkëpunim me QTTB.
4. Njohja dhe rekomandimi ndaj Sherbimit të Ekstensionit me strukturat varjetore sipas kulturave në tersi.
5. Promovimi i Marketingut të produkteve bujqësore e blektorale si dhe krijimit të grupeve të fermerëve SHBB.
6. Nxitja e fermerëve potenciale për kryerjen e analizave të tokës dhe hartimin e një bilanci plerimi.



7. Mbledhja, përpunimi, zhvillimi i statistikave në funksion të realizimit të Rregjistrave të Firms, Vjetarit Statistikor, VVB, VSM, Evidence koherente duke respektuar parimet themelore të statistikave të miratuara nga Kombet e Bashkuara, Kodi i Praktikave të Statistikave Evropiane, Dispozitat e Ligjit Evropian Statistikor, Programit Kombëtar për Statistikat Zyrtare 2022-2026 ligjit si dhe për statistikën Zyrtare në RSH.

III. Vlerësimi i risqeve

Operacional /proceduralë

a. Personel i pamjaftueshëm për të mbuluar proceset e rëndësishme në stafin e AREB-it por dhe atë rreth 1 vakance në sistem *Ekstensionist* duke ndikuar kështu edhe në rritjen e performancës

III. Vlerësimi i faktorëve të riskut

Operacionalë

- Mungesë informacioni në zbatim të akteve ligjore .
- Mungesë informacioni nga specialistet e profilizuar, lidhur me keshillimin e duhur për shërbimin e ekstensionist, ekstensionistet.

10. PLANI I VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E RISKUT


Grupi i Punës hartoj planin e veprimit me synim menaxhimin e risqeve të integritetit në AREB Shkodër ku nëpërmjet tij u evidentua: risku, kontrolli dhe ndërmara deri më tani , veprimet për të adresuar boshllëqet në institucion, zotëruesit e riskut , dhe ndërkohë u ndërmorën masa të reja monitorimi dhe kontrolli për përmirësimin e masave ekzistuese. Po kështu u përcaktuan masat e integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre në vijim. Zbatimi i Planit të Integritetit është parashikuar për periudhën 2025 e në vazhdim.

Plani i Veprimit 2025–2027 për AREB Shkodër përfaqëson një angazhim strategjik për forcimin e integritetit institucional dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj komunitetit bujqësor. Ky plan është ndërtuar mbi analizën e risqeve që prekin fushat kyçe të veprimtarisë së institucionit dhe parashikon masa konkrete për rritjen e efektivitetit organizativ dhe funksional.

Plani mbështet zbatimin e politikave kombëtare për zhvillimin rural dhe përbën një mjet operacional për përforcimin e transparencës, kapaciteteve njerëzore dhe qasjes bashkëkohore ndaj fermerëve të rajonit.

Objektivat kryesorë të Planit:

1. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore – me fokus në organizimin më të mirë të punës, trajnimin e vazhdueshëm dhe rritjen e kapaciteteve institucionale.




2. Sigurimi dhe shpërndarja e informacionit të përditësuar për bujqësinë dhe agropërpunimin – duke përfshirë takime me fermerë, demonstrime praktike dhe mbështetje teknike në terren.

Nr.	Aktiviteti	Produkti	Risqet dhe faktorët e riskut	Prioriteti	Masa për adresimin e riskut	Struktura përgjegjëse	Afati
1.1	Trajnime të vazhdueshme për punonjësit	Stafi i kualifikuar	Nevoja për përmirsim për realizimin cilësor të detyrave	I mesëm	Hartimi i një plani mujor trajnime në bashkëpunim me ASPA	AREB Shkodër & ASPA	Fillimi i çdo viti
1.2	Plotësimi i vendeve vakante	Strukturë e plotësuar	Mungesë mbulese për zonat e largëta dhe vonesa në ofrimin e shërbimeve	I lartë	Kërkesa të vazhdueshme në DAP për rekrutime	Burimet njerëzore	6-mujori i dytë 2025
1.3	Hartimi i planeve mujore të detyrave operacionale	Planet mujore të punës	Mosrealizimi efektiv i detyrave operacionale dhe objektivave	I mesëm	Hartimi i planeve mujore të punës	Sektoret AREB Shkoder	Fillimi i çdo viti
1.4	Kërkesë për shtesë stafi: jurist dhe IT	Strukturë funksionale	Vonesë në përpunimin e dokumentacionit dhe mungesë asistence teknike	I lartë	Dërgimi i kërkesës në MBZHR dhe DAP për shtesë stafi	Drejtuesi i institucionit	Deri në fund 2027

Objektivi 2: Sigurimi i informacionit bashkëkohor për bujqësinë

Nr.	Aktiviteti	Produkti	Risqet dhe faktorët e riskut	Prioriteti	Masa	Struktura përgjegjëse	Afati
2.1	Organizimi i ditëve të fushës, trajnimeve, demonstrimeve	Informim i përditësuar për fermerët	Vonesë në shpërndarjen e informacionit për shkak të mungesës së stafit dhe	I lartë	Hartimi i kërkesës për shtesë stafi dhe logjistike për mbulimin	Të gjithë sektoret AREB	Në vazhdimsi



	e dhe vizitave në ferma		logjistikës, si dhe terrenit të vështirë		e zonave të thella		
2.2	Organizimi i fushatave informuese në shkolla të mesme dhe universitete bujqësore	Rritja e interesit të rinjve për bujqësinë	Plakje e popullsisë aktive në bujqësi dhe mungesë pasardhësish në fermat familjare	I lartë	Planifikimi i vizitave dhe takimeve edukative në shkolla	AREB Shkodër me bashkëpunim të DAR dhe universiteteve	Gjatë gjithë vitit 2026
2.3	Mbështetje dhe orientim për gratë fermerë	Rritje e pjesëmarrjes së grave në aktivitetet bujqësore	Gra të përjashtuara nga vendimmarrja dhe pa qasje në informim e fonde	I mesëm	Organizim takimesh specifike për gratë dhe ndarje informacioni mbi grante, programe etj.	Drejtuesi dhe sektori i ekstensionit	Fillimi i 2027

11. INTEGRITETI DHE SHKELJA E INTEGRITETIT

Integriteti i AREB Shkodër përbën një standart të domosdoshëm me qëllim mirfunksionimin e sistemit të menaxhimit të këtij standarti, i cili bazohet mbi të gjitha në vlersimin e riskut.

Shkeljet e integritetit konsistojnë:

- Përvetësim, shpërdorim apo devijim i fondeve në AREB Shkodër
- Trajtim i fermerëve në mënyrë të pabarabartë apo të padrejtë.
- Mosrespektim i procedurave administrative dhe ligjore.
- Neglizhenca në zbatimin e detyrave.
- Kërkesa dhe procedura të tepërta administrative.

Implementimi i një plani masash antikorrupsion me synim adresimin e risqeve të integritetit në strukturat e AREB me qëllimin përmisimin e efikasitetit, efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënjes institucionale, si dhe rritjen e besueshmërisë së shërbimit të Ekstensionit.

12. MENAXHIMI I RISQEVË TË INTEGRITETIT NE AREB

Menaxhimi i riskut të integritetit përfaqëson një proces të vazhdueshëm dhe sistematik, i cili në vetvete adreson risqet rregullatore, organizative dhe praktikë të integritetit që në vetvete i përkasin AREB -it në kohezion, por dhe të ardhmes së veprimtarisë saj. Në vetvete fusha e veprimit përvlersimin e riskut paraqitet fleksible, pasi vet plani i integritetit të AREB i referohet proceseve të punës dhe shërbimeve brenda institucionit duke u fokusuar tek çdo funksion administrativ.



Ne kete konteks ,ky sistem sherben si nje instrument parandalues i korrupsionit ne AREB Shkodër.

13.PLANI I INTEGRITETIT

Plani i Integritetit është një dokument strategjik dhe operativ ,detyrim ligjor i cili mbështet në rezultat e procesit të vlersimit të riskut të integritetit për të gjitha proceset e punës në AREB.

Ky plan i shërben institucionit në indentifikimin ,vlersimin dhe parandalimit e tërësisë së rreziqeve që çenojnë integritetin e institucionit , personelit që punojnë për të dhe në vetvete përfaqeson një proces të dokumentuar që vleron nivelin e cënueshmërisë së AREB Shkodër si dhe ekspozimin e tij ndaj korrupsionit dhe praktikave joetike dhe joprofesionale.

Plani i Integritetit në AREB Shkodër do të mundësojë ofrimin e një kornize rregullatore , brenda të cilës do të përfshihen të gjitha politikat dhe masat që do të ndiqen në vijim për të parandaluar shkeljet e integritetit nga ekstensionistët dhe specialistët e tjerë,si dhe monitorimin e efekteve të masave të zbatuara në funksion të zbatimit të bazës ligjore , lidhur me implementimin e e strategjisë ndërsektoriale kundër korupsionit,pasaportës së indikatorve dhe zbatimit të detyrave përkatëse.

Plani i Integritetit për AREB Shkodër do të ndikojë pozitivisht në të ardhmen në rritjen e cilësisë së punës së institucionit dhe të ofrimit të shërbimit te keshillimit për fermeret ne perputhje me legjislacionin. Jemi të ndërgjegjshëm se dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtuese, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etikën, do të sigurojnë një brendësim dhe zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet e institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e kredibilitetin institucional.

Gjithashtu ,plani përfaqëson një dokument pune ku në veçanti përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të AREB-it.

14.QELLIMI I PLANIT TE INTEGRITETIT....

Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion konsiston në:

- Vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë aftësinë e Agjencise së Ekstensionit Bujqesor Shkodër për të kryer funksionin e shërbimit publik të Ekstensionit në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme.
- Integriteti konsiston në të qenit transparent,llogaridhënës,me etikë dhe i ndershëm,efektiv dhe eficient për përmisimin e performances dhe zvoglimin e niveleve të korrupsionit.



- AREB Shkodër përballlet me me risqe të integritetit të ndryshme të cilat pengojnë realizimin e objektivave strategjike, apo programore të institucionit.
- Vlerësimi i faktorëve të riskut.
- Hartimi i masave të përshtatshme për adresimin në mënyrë metodike të risqeve të evidentuara.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë të AREB Shkodër si më poshtë vijonë :

- menaxhimin financiar.
- menaxhimin e burimeve njerëzore.
- kontrollin, monitorimin dhe mekanizmat kundër korrupsionit.
- transparencës;
- arkivimin.
- ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve si dhe informacionit.
- planifikimin dhe administrimin e buxhetit të institucionit , forcimin e mardhenjeve nderistitucionale si dhe bashkerendimi i punes ne mardhenjet nderinstitucionale dhe partneret.

15. PARIMET E VLERSIMIT TE RISKUT PER AREB

Vlersuar metodologjise se cituar parimet e vlersimit te riskut perfshijne

- Minimizimin e pushtetit diskrecional te teper e panevojshem qe zoterone autoriteti ekzekutiv, administrata ,struktura apo persona te vecante ne vendimarrje si dhe qartesimin e percaktimin e kriterëve ,procedurave dhe standarteve per procesin e vendimarrjes,si dhe thjeshtezimin dhe riorganizimin e procedurave te panevojshme.
- Rritja e mekanizmave monitorues e te kontrollit te aktivitetit,me synim ruajtjen e sistemit kontroll/ balance dhe parimin e ndarjes se pushteteve,duke rritur trasparencen dhe llogaridhenjen ne AREB Shkodër.

Adresa: Bulevardi "Zog i I-rë" Shkodër

